



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:287469  
Datë: 23.01.2024  
Numri i dokumentit: 05229142

**C – I - 23 - 0048**

**Paditësi - propozuesi i sigurimit:**

I I nga Prishtina, numër personal..., Prishtinë e të cilin me autorizim e përfaqëson, Avokatia me seli në Prishtinë, "H R", Prishtinë, e me av. R F nga Prishtina dhe av. M B nga Prishtina,

**Kundër:**

**E paditura - kundërshtarja e sigurimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lagja "Lakrishtë", Prishtinë.

**Objekti i çështjes:** propozimi për caktimin e masës së sigurimit.

**Për:** Palët ndërgjyqëse.

**Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me Kolegjin në përbërje nga gjykatësi, Agron Hoxhaj, gjykatës kryesues, gjykatësi, Bajram Miftari, dhe gjykatësi, Hasim Sogojeva, antarë të kolegjit, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.23.01.2024, lëshon këtë**

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa e paditësit – propozuesit të sigurimit, I I nga Prishtina e me të cilën ka kërkuar :''që të caktohet masa e sigurimit dhe t'i NDALOHET, paditurës - kundërshtarës së sigurimit, Agjencisë Kosovare të Privatizimit me seli në Prishtinë, që të ndërmarrë veprime në drejtim të shitjes, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit/administrimit me lokalin afarsit L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, Dardania, kati i ndërmjetëm, i cili është në posedim të paditësit, si dhe të obligohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit që të pezulloj zbatimin e Vendimit, Nr.Ref.BD – 189/29 të dt.30.10.2023 deri në zgjidhjen meritore të kësaj çështje''.

**II. Nuk caktohen taksat tjera gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore .**

## Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi me dt.19.12.2023, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (tani e tutje, Dhoma e Posaçme) kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, ka paraqitur padinë për shkak të anulimit të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Nr.Ref.BD.- 189/29 të dt.30.10.2023 e me të cilin është aprovuar Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-së i dt.15.09.2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, PS/SDR/ - 1537U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës, "Nacional", Beograd, asetet në Prishtinë/Kosovë e me të cilin padi ka kërkuar nga gjykata që të merr aktgjykim e me të cilin do t'aprovtoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, t'a anuloj, Vendimin, Nr.Ref.BD – 189/29 të dt.30.10.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të obligohet e paditura që t'i paguaj të gjitha shpenzimet gjyqësore lidhur me këtë çështje gjyqësore deri në përfundimin e këtij procesi gjyqësor me vendim të formës së prerë dhe i ka propozuar gjykatës që të caktohet masa e sigurimit dhe ndalohet e paditura – kundërshtarja e masës së sigurimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit, të ndërmarrë veprime në drejtim të shitjes, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit/administrimit me lokalin afarsit L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, Dardania, kati i ndërmjetëm, i cili është në posedim të paditësit, si dhe të obligohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit që të pezulloj zbatimin e Vendimit Nr.Ref.BD – 189/29 të dt.30.10.2023 deri në zgjidhjen meritore të kësaj çështje.

Paditësi – propozuesi i sigurimit, në këtë padi, ka theksuar në mes tjerash se objekt i kësaj padi është lokalin afarist me adresë në Prishtinë, Rr.D, , me sipërfaqe të përgjithshme prej 63.03 m<sup>2</sup>, lidhur me të cilin e paditura, pretendon se është në administrimin dhe juridiksionin e saj, se me dt.30.10.2023, e paditura, kishjte nxjerr Vendimin Nr.Ref.BD. - 189/29 të dt.30.10.2023, ka aprovuar Raportin Shqyrtues të Komisionit për Shqyrtimin eKPS-së të dt.15.09.2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, PS/SDR/ - 1537U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës, "Nacional", në Prishtinë, pjesë e së cilave, është edhe lokali i lartëcekur, e duke përshkruar historikun e kësaj ndërmarrje prej regjistrimit të saj si shoqëri aksionare në Beograd, në bazë të regjistrimit gjyqësor, Nr.1 – 12951 – 00 të 22.10.2003 të Gjykatës Tregtare në Beograd e deri tek lëshimi faturës, nr.01/02 – OS dhe vërtetimi për ekzekutimin e pagesës nga paditësi si dhe inicimi i padisë për vërtetimin e pronësisë në Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe e cila mban numrin, C – III. – 18 – 0049, se në këtë padi ka cekur bazën ligjore të kërkesëpadisë së tij sipas Ligjit. Nr.03/L – 034 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si dhe për çështjen e pronësisë e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësi – propozuesi i sigurimit, kësaj padie dhe propozimit për caktimin e masës së sigurimit, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse :

- Kopja e Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Nr.Ref.BD. - 189/29 të dt.30.10.2023;
- Kopja e kontratës për bashkim të fondeve e dt....;
- Kopja e Shpalljes publike e dt.04.06.2002 në gazetën zyrtare, " privredni pregled";
- Kopja e Vendimit, nr.1301 të dt.18.VI.2002, Beograd për shpalljen e blerësit të lokalit, L 2 me sipërfaqe 63.03 m<sup>2</sup> ;
- Kopja e autorizimit për F B dhe kontrata e shitëblerjes Nr... e dt...;
- Kopja e kontratës së shitëblerjes, Nr... e dt... e lidhur në mes, Shoqërisë Akcionare "Nacional" me seli në Beograd dhe I I nga Prishtina për blerjen e lokalit;

- Kopja e faturës, Nr.01/02 – OS e dt.19.06.2002 për kryerjen e pagesës sipas kontratës së shitëblerjes, Nr... e dt.... ;

- Vërtetimi, Nr.1329 për ekzekutimin e pagesës nga paditësi, dhe

- Kopja e shkresës së AKP-së, nr.2647/2023, nr.1 e dt.17.11.2023 për shfrytëzuesit e pronës së Ndërmarrjes, "Organizata e Punës, "Nacional" të drëguar në adresë të paditësit – propozuesit të sigurimit.

Paditësi – propozuesi i sigurimit, në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, në mes tjerash ka cekur nenin 61.1 të Ligjit, Nr.06/L – 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku për caktimin e masës së sigurimit, kërkohet plotësimi i dy kriterëve ligjore për caktimin e masës së sigurimit: q) ekzistimi i kërkesës apo të drejtës subjektive, dhe b) rreziku i shkaktimit të dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm në rast se nuk ndërmerret.

Paditësi – propozuesi i sigurimit, në propozimin e tij për caktimin e masës së sigurimit, ka theksuar se i njëjti, e ka blerë lokalin afarsit L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, Rr.Dardania, përmes kontratës së shitëblerjes sipas rregullave ligjore të asaj kohe dhe është posedues i të njëjti edhe sot e kësaj dite, se në shkreset e lëndës, ka parashtruar dëshmi se ka paguar shumë prej 27,000 euro (njëzetë e shtatë mijë) në bazë të kontratës së shitëblerjes, nr,1316 e lidhur me shoqërinë akcionare, "Nacional" A.D në cilësinë e shitëses, si dhe pagesën e ka vërtetuar në bazë të vërtetimit për ekzekutimin e pagesës dhe mbylljes së detyrimit të lëshuar nga kjo e fundit, se në rastin konkret është plotësuar kushti i parë ligjor nga 61 par.1.1 i Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar (fumus boni iuris), dhe se ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm në rast se masa e sigurimit nuk ndërmerret, se e paditura, në bazë të Vendimit Nr.Ref.BD. - 189/29, ka konstatuar se pa luajtshmëria (lokali), e cila është objekt kontesti midis palëve ndërgjyqëse, si aset i SH.A, "Nacional" A.D, është e fituar me mjete shoqërore rrjedhimisht është në pronësi shoqërore dhe kësajsoji e njëjta bie në administrimin dhe juridikcionin e AKP-së, e në bazë të ne nit 1 dhe 2 të Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AKP-ja, ka të drejtën absolute që t'i administroj, shes, transferoj dhe likuidoj të gjitha ndërmarrjet Shoqërore dhe asetet e tyre të cilat ndodhen brenda territoreit të Republikës së Kosovës, se ai që nga momenti i blerjes së lokalit është pronar dhe posedues me mirëbesim i të njëjtit mbi bazën e kontratës së shitëblerjes, se duke e ditur se paditësi, është posedues i lokalit, i cili është objekt i këtij kontesti, pas nxjerrjes së Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Nr.Ref.BD.- 189/29 të dt.30.10.2023, e paditura, ia ka dërguar paditësit shkresën e saj, nr.2647/2023, nr.1 e dt.17.11.2023 për shfrytëzuesit e pronës së Ndërmarrjes, "Organizata e Punës, "Nacional", e duke e informuar se ishte duke e shfrytëzuar asetin e ndërmarrjes në fjalë pa marrveshje me AKP-në, e në mes tjerash me këtë shkresë, i kishte kërkuar që të ofroj dokumente mbi bazën e të cilave është duke e shfrytëzuar pronën, detyrohej që të hynte në marrdhënie kontraktuale të qirasë me AKP-në dhe si kusht për të hyrë në këto marrdhënie kontraktuale, ishte pagesa e qirasë në mënyrë retroaktive për 3 vitet e fundit e nëse nuk do t'i realizonte këto kërkesa, është njoftuar se është i detyruar të liroj asatin në fjalë (lokalin afarist L 2, objekt kontesti dhe se AKP-ja, do tëndërmarr veprime ligjore para gjykatës me qëllim të kompensimit.

Tutje, paditësi, ka theksuar se po i rrezikohet shkelja e të drejtës së pronësisë në mënyrë flagrante duke e larguar kundërligjshëm nga prona e tij dhe duke e detyruar që t'a paguaj qiranë

në mënyrë retroaktive për 3 vitet e fundit në rast të mbajtjes në posedim të lokalit mbi bazën e kontratës së qirasë me AKP-në, se atij po i rrezikohet edhe shkaktimi i rrezikut të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm, se ka cituar dispozitat e nenit 3 të Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që kanë të bëjnë me se çka përbën Ndërmarrje Shoqërore, se dëmi i menjëhershëm konsiston në atë se lokali afarist do të vendoset nën administrimin e AKP-së ndërsa ai do të detyrohet në pagimin e qirasë, se AKP-ja, menjëherë në raundin e radhës do t'a vendos asetin në shitje përmes tenderit publik, se shitja do të nëkuptonte dorëzimin nëposedim dhe pronësi tek një person i trete nëse ndodh shitja e asetit për të cilën paditësi, ka inicuar këtë padi, kjo cenon të drejtën në gjykim të drejtë (neni 6 i KEDNJ-së) dhe të drejtën në mbrojtje të pronës (neni 1 Protokollit 1 të KEDNJ-së), se dëm i riparueshëm, konsiston në atë se nuk ka një zhdëmtim të arsyeshëm financiar, sado që gjykata do të caktonte çmimin për lokalin afarist kontestues, se ky dëm konsiston në mohimin e një të drejte themelore të njeriut, se beson se me provat e parashtruara si dhe faktet dhe argumentet ligjore vërtetojnë dhe e bëjnë të besueshëm pretendimin se aseti – lokali L 2 me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, nuk i posedon tiparet e asetit në pronësi të një Ndërmarrje Shoqërore nën juridiksionin e Agjencisë, e rrjedhimisht nuk i plotëson kriteret ligjore që ky asset të tjetërsohet nga Agjencia pa poseduar as dhe të vetmin dokument, provë apo fakt juridik si dëshmi se ky aset bie nën juridiksionin e Agjencisë, andaj i ka propozuar gjykatës që të merr aktvendim e me të cilin do të caktohet masa e sigurimit e ushtruar nga propozuesi, I I nga Prishtina, dhe t'i ndalohe të paditurës/kundërshtarës së sigurimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit, që të ndërmarre veprime në drejtim të shitjes, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit/administrimit me lokalin afarsit L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, Dardania, kati i ndërmjetëm, dhe i cili është në posedim të paditësit, si dhe të obligohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit që të pezulloj zbatimin e Vendimit, Nr.Ref.BD – 189/29 të dt.30.10.2023 deri në zgjidhjen meritore të kësaj çështje.

Me dt.21.12.2023, Dhoma e Posaçme, me Urdhrin e saj, C - I. – 23 – 0048 të dt.21.12.2023, të paditurës – propozuese së sigurimit, AKP-së, i ka dërguar padinë dhe kërkesën e paditësit propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit.

Me dt.27.12.2023, e paditura, AKP meseli në Prishtinë, ka paraqitur përgjigje në padi e në të cilën ka theksuar se i konteston në tërësi, padinë dhe pretendimet e paditësit si dhe provat e propozuara, se Bordi i Drejtorëve i AKP-së, ka vepruar drejtë në pajtim me ligjin e për AKP-në me aprovimin e Raportit Shqyrtues të Komisionit për Shqyrtimin e KPS-së të dt.15.09.2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, PS/SDR/ - 1537U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës, "Nacional", në Prishtinë e më gjerësisht si në këtë përgjigje në padi derisa në të njëjtën ditë, pra me dt.27.12.2023, e paditura – kundërshtarja e sigurimit, AKP-ja me seli në Prishtinë, ka paraqitur përgjigje në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit e duke konsideruar se propozuesi në propozim duhet tregoj edhe faktet mbi të cilat e mbështet propozimin si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim, e të cilat mjete sipas mundëive propozuesi duhet t'ia bashkagjes propozimit për caktimin e masës së siguris se rasti i tillë duhet të jetë për shembull kur propozuesi e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurisë është e bazuar, duke prezentuar urgjencën e çështjes e cila kërkohet lidhur me atë rast dhe se me veprimin ndryshe do të humbte qëllimi i sigurimit të kërkesëpadisë, se e paditura, AKP-ja, sqaron se baza juridike për vendosje e e masave nga DhPGJSK-ja, është neni 61 i Ligjit të DhPGJS-së, se parashtruesi duhet në kërkesën për masën e sigurisë, të paraqes një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të hollsishtme dhe rrethanave faktike prej të cilave mund të nxirret përfundimi se ekziston dëmi gjithëpërfshirës, i cili është **i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm**, se me **dëm** do të duhej kuptuar jo vetëm humbja

financiare apo monetare por edhe çdo kuadër i rrethanave që rrezikon apo dëmton të drejtën e pretenduar nga parashtruesi (periculum in mora), e me fjalën, **i menjëhershëm**, do të duhej nënkuptuar diçka që është duke ndodhur, por gjithashtu diçka që në pajtim me rrethanat, është e pa shmangshme, me mundësi të mëdha për të ndodhur në një të ardhme të afërt, duke pasur parasyh kohëzgjatjen e e procedurës së urdhrimit paraprak gjyqësor, se me fjalën, i pariparueshëm do të duhej nënkuptuar ajo çfarë nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme, veçanërisht për nga natyra e vet apo nga vështirësitë e llogaritjes, me anë të një kompensimi monetar, se me **prova të besueshme** do të duhej nënkuptuar se është veçmas e dmosodoshme të krijohet te gjyqëtarët në mënyrë, "summario cognito", bindjen "prima facie", se parashtruesi ka të drejtë në pretendimin se ekziston "fomus boni iuris", se nga të lartëcekurat, e paditura, Agjencia i ka propozuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, që pas shqyrtimit të provave dhe thënieve nga e paditura, të nxjerr aktvendim e me të cilin, hedhet poshtë si e pa pranueshme kërkesa për lëshimin e masës së sigurisë apo në të kundërtën të refuzohet si e pabazuar kërkesa për lëshimin e masës së sigurisë e paditësit ose të merr aktgjykim me të cilin refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit e më gjerësisht si në këtë Përgjigje në padi dhe Përgjigjen në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për lëshimin e masës së sigurisë dhe se kësaj Përgjigjeje ia ka bashkangjitur, provat : kopjen e shkresës, Nr.2647/2023 të dt.17.11.2023 të Zyrës Rajonale të AKP-së në Prishtinë për shfrytëzuesit të aseteve të pronës shoqërore e të dërguar në adresë të shfrytëzuesit të Ndërmarrjes,"Organizatë e Punës, "Nacional", dhe Raportin përmbledhës të Komisionit nga shqyrtimi i kërkesës për përcaktimin e statusit juridik të aseteve të Ndërmarrjes, OP, "Nacional", Beograd, Njësia Punuese në Prishtinë.

Me dt.04.01.2024, kjo gjykatë, me Urdhrin e saj, C – I. - 23 – 0048 të dt.04.01.2024, përgjigjen e të paditurës – kundërshtarës së sigurimit, AKP-së me seli në Prishtinë të bërë në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, ia ka dërguar paditësit – propozuesit të sigurimit.

Me dt.16.01.2024, paditësi – propozuesi i sigurimit, ka paraqitur përgjigje në Përgjigjen e dhënë nga e paditura në padinë e paditësit por edhe ndaj përgjigjes së dhënë nga e paditura – kundërshtarja e sigurimit, AKP-ja në propozimin e tij për caktimin e masës së sigurimit e në të cilën në mes tjerash i ka cekur arsyet e njëjta të thëna në propozimin e tij për caktimin e masës së sigurimit e veçmas duke kërkuar nga gjykata që t'a anuloj, Vendimin, Nr.Ref.BD – 189/29 të dt.30.10.2023, dhe që të caktohet masa e sigurimit, t'i ndalohet e paditura të ndërmarrë veprimet në drejtim të shitjes, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit/ administrimit me lokalit, objekt i këtij kontesti e më gjerësisht si në këtë Përgjigje të dhënë në Përgjigjen e të paditurës e të paraqitur në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit.

### **Arsyetimi ligjor**

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar

Ligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm, zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr.03/L-006), me Ndryshimet dhe Plotësimet e këtij ligji dhe se kjo çështje është definuar me nenin 76 paragrafi 3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ku është theksuar, se *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Në bazë të nenit 76 par.3 dhe nenit 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmbajnë propozimi, nuk e vërtetojnë propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe se gjykata merr aktvendim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të propozimit të paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit si dhe pretendimeve të të paditurës – kundërshtarës së sigurimit të dhëna në përgjigjen e saj të dhënë propozimin për caktimin e masës së sigurimit, dhe në kundërpërgjigjen e saj të dhënë në përgjigjen e paditësit – propozuesit të sigurimit, gjykata ka vlerësuar dhe ardhur në përfundimin se propozimi i paditësit – propozuesit të sigurimit, për lëshimin e masës së sigurimit, në këtë çështje juridike, është i pa bazuar,

Në bazë të nenit 61 par.1 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se : *“... Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kushte që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pa riparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar...”*. Në rastin konkret, paditësi – propozuesi i sigurimit, i ka propozuar gjykatës që të caktohet masa e sigurimit dhe t'i ndalohej të paditurës – kundërshtarës së sigurimit, Agjencisë Kosovare të Privatizimit të ndërmarre veprime në drejtim të shitjes, tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo disponimit/administrimit me lokalin afarisht L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, Dardania, kati i ndërmjetëm, i cili është në pocedim të paditësit, si dhe të obligohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit që të pezulloj zbatimin e Vendimit Nr.Ref.BD – 189/29 të dt.30.10.2023 deri në zgjidhjen meritorë të kësaj çështje.

Dhoma e Posaçme, sipas formulimit ligjor të cekur më lartë, mund të nxjerr masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofroj prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme derisa në rastin konkret, paditësi – propozuesi i sigurimit, me provat e bashkagjitura padisë dhe propozimit të tij për caktimin e masës së sigurimit, e ka provuar se ekzistojnë rrethana të cilat, e bëjnë të besueshëm faktin se dëmi është i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm sepse e paditura – kundërshtarja e sigurimit, AKP-ja me seli në Prishtinë, që asetin, patundshmërinë - lokalin afarisht L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, D, kati i ndërmjetëm, i cili është në pocedim të paditësit, mund t'a shes përmes tenderimit publik, pra ekziston mundësia e ndërmarrjes së veprimeve tjera juridike nga e paditura- kundërshtarja e sigurimit, siç mund të jetë shitëblerja – bartjes së pronësisë në persona të tretë, lënien në hipotekë dhe peng si dhe

çfarëdo ndryshimi në regjistrat e paluajtshmërisë në patundëshmërinë e paditësi – propozuesit të sigurimit nga ana e të paditurës – kundërshtarëve të sigurimit.

## **Provat e besueshme**

Për të përcaktuar kushtet paraprake rreth miratimit të masës së përkohshme të sigurimit, paditësi – propozuesi i sigurimit, iu është referuar provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, siç janë : Kopja e kontratës për bashkim të fondeve e dt.09.11.1989, kopja e Vendimit, nr.1301 të dt.18.VI.2002, Beograd për shpalljen e blerësit të lokalit, L 2 me sipërfaqe 63.03 m<sup>2</sup>, kopja e faturës, Nr.01/02 – OS e dt.19.06.2002 për kryerjen e pagesës sipas kontratës së shitëblerjes, Nr.1316 e dt.18. VI.2002, vërtetimi, Nr.1329 për ekzekutimin e pagesës nga paditësi e veçmas: kopjes së kontratës së shitëblerjes, Nr.1316 e dt.18.VI.2002 e lidhur në mes, Shoqërisë Akcionare’’Nacional’’ me seli në Beograd dhe I I nga Prishtina për blerjen e lokalit dhe se Kolegji i kësaj gjykate, konsideron në mënyrë qartë, se paditësi – propozuesi e sigurimit, I I nga Prishtina, prapë se prapë, nuk ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së tij subjektive që të pranohet propozimi i tij për caktimin e masës së sigurimit, andaj Kolegji i DhPGjSK-së, pa paragjykuar për vendosjen e tij kësaj lidhur me pjesën kryesore të kërkesëpadisë së paditësit – anulimi i Vendimit, Nr.Ref.BD – 189/29 të dt.30.10.2023 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e bazuar në dokumentet e paraqitura, për natyrën e pretenduar juridike si dhe mbi atë se a i cenohet e drejta pronësore mbi paluajtshmërinë, nga dokumentet e parashtruara më lartë, e duke qenë se lokali afarist nuk evidnetonet as në emrin e të paditurës, AKP-së, e njëjta nuk mund të zhvilloj procedurën e pretenduara të tenderimit të asetit – lokalit afarist lokalit, L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, Dardania, kati i ndërmjetëm, dhe i cili është blerë nga paditësi që mëse 20 vite si dhe se deri më tani ky lokal afarsit, është në pocedim të paditësit, të njëjtit, pra me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, tani për tani nuk ka arsye që paditësit – propozuesit të sigurimit, se do t’i shkaktohej dëm i pariparueshëm nga veprimet e të paditurës, AKP me seli në Prishtinë.

Gjykata konstaton se parakushti mbi provat e besueshme sipas nenit 61 të Ligjit të DhPGjSK-së, në rastin e paditësit – propozuesit të igurimit, nuk është plotësuar derisa kjo gjykatë mori për bazë edhe pretendimet e të paditurës - kundërshtarës së sigurimit, të bëra në përgjigjjen e saj të dhënë në propozimin e paditësit – propozuesit të sigurimit se ajo si menaxhuese e aseteve të NSh-ve, ka vepruar drejtë në pajtim me Ligjin për AKP-në kur e ka bërë aprovimin e Raportit Shqyrtues të Komisionit për Shqyrtimin e KPS-së të dt.15.09.2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, PS/SDR/ - 1537U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës, ’’Nacional’’, në Prishtinë, e duke i propozuar gjykatës, që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit.

## **Dëmi i menjëhershëm**

Meqenëse, patundëshmëria, aseti – lokalit afarist lokalit, L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, D, kati i ndërmjetëm, dhe i cili është blerë nga paditësi që mëse 20 vite si dhe se deri më tani ky lokal afarsit, është në posedim të paditësit, si dhe se i njëjti përmes kontratës së shitëblerjes sipas rregullave ligjore të saj kohe dhe është posedues i të njëjti edhe sot e kësaj dite, se në shkresat e lëndës, ka parashtruar dëshmi se ka paguar shumën prej 27,000 euro (një zetë e shtatë mijë) në bazë të kontratës së shitëblerjes, nr,.. e lidhur me shoqërinë akcionare, ’’Nacional’’ A.D në cilësinë e shitëses, si dhe pagesën e ka vërtetuar në bazë të vërtetimit për ekzekutimin e pagesës dhe mbylljes së detyrimit e lëshuar nga kjo e fundit, dhe se me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, në rastin konkret nuk është plotësuar kushti i parë ligjor nga 61 par.1.1 i Ligjit për

Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar (fumus boni iuris), dhe se ekziston rreziku i shkakimit të demit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm në rast se masa e sigurimit nuk ndërmerret, andaj edhe kjo gjykatë konsideron se propozimi i paditësit – propozuesit së sigurimit, I I nga Prishtina për caktimin e masës së sigurimit, nuk i plotëson kriteret ligjore në frymën e nenit 61 par.1 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në vështrim të shkakimit të demit të menjëhershëm sepse nuk ekziston mundësia reale që e paditura - kundërshtarja e sigurimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, edhe pas aprovimit të Raportit Shqyrtues të Komisionit për Shqyrtimin e KPS-së të dt.15.09.2023 lidhur me statusin juridik të aseteve, PS/SDR/ - 1537U/PRN193, Ndërmarrjes Organizatë e Punës, "Nacional", në Prishtinë, dhe atë në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Nr.Ref.BD.- 189/29 të dt.30.10.2023 por edhe në mungesë të evidencës kadastrale në emrin e saj të këtij lokali afarist, e paditura – kundërshtarja e sigurimit, nuk mund të ndërmarr veprime juridike që asetin – lokalin afarist lokalit, L 2, me sipërfaqe prej 63.03 m<sup>2</sup>, me adresë në Prishtinë, Dardania, kati i ndërmjetëm, e në funksion të qitjes së tij në tender publik për shitjen si dhe të ndërmarrë veprimet tjera në drejtim të tjetërsimit, fshehjes apo ngarkimi apo disponimit/administrimit me lokalin në fjal afarist dhe se paditësit – propozuesit së sigurimit, I I nga Prishtina, nuk mund t'i shkaktohet dëm i pa riparueshëm, andaj edhe Kolegji i DhPGJJK-së, propozimin e paditësit – propozuesit së sigurimit, I I nga Prishtina për caktimin e masës së sigurimit, e refuzoj si të pabazuar.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4 par.9, 9 dhe nenit 61 par.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DhPGJJK).

### **Shpenzimet procedurale:**

Paditësi – propozuesi i sigurimit, ka paguar taksën gjyqësore për propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe atë në shumën prej 100.00 € dhe se për këtë arsye, gjykata nuk caktoj taksa tjera gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore.

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2023:287469, 23.01.2024**

Kolegji i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Agron Hoxhaj, Gjykatës kryesues \_\_\_\_\_

Bajram Miftari, Gjykatës \_\_\_\_\_

Hasim Sogojeva, Gjykatës \_\_\_\_\_

### **KËSHILLË JURIDIKE :**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.



Numri i lëndës: 2023:287469  
Datë: 23.01.2024  
Numri i dokumentit: 05229142